

Intervistë me Sh.T. z. Aivo Orav,

(30/07/2015)

SHEF I DELEGACIONIT TË BASHKIMIT EVROPIAN PËR SERVISIN PUBLIK RTVM



Para dy javë, këtu, në rezidencën në Përzhino, nga katër liderët të partive më të mëdha politike në Maqedoni u nënshkrua marrëveshja. Për gjendjen politike, perspektivat e BE-së, bisedoj me Ambasadorin e BE-së në vendin ton, Ambasadori Aivo Orav.

Lehtësimi evropian, z. Ambasador e përmirësoj dialogun politik në Maqedoni. Cili është qëndrimi për dokumentin e nënshkruar pas negociatave disa mujore dhe si rrjedhë dinamika, a kanë filluar implementimi pjesëve të marrëveshjes?

Së pari, dëshiroj të ju falënderohem që erdhët këtu. Mendoj se do të ishte shumë më mirë nëse nuk do të ekzistonte nevojë për negociata të tilla, nëse partitë politike do të mundej të bisedonin midis vete dhe të gjenin zgjedhje vetë. Në këtë rast, BE-ja dhe SHBA-të u ndihmuan partive që të arin marrëveshje dhe kjo u realizua.

Marrëveshja u arrite me shumë vonesë dhe shumë kohë e rëndësishme për këtë vend u humbë. Por më në fund marrëveshja u arrit dhe shpresoj se kjo është fundi i krizës politike që në fakt filloi nga 24 dhjetori 2014. Tani ju keni një marrëveshje, edhe ne gjithashtu kemi dhe shpresoj se marrëveshja do ta hap përsëri rrugën e shtetit drejt BE-së dhe NATO-së.

Maqedoninë tani e pret shumë punë, nevojitet zbatimi i shumë reformave. Cilat janë prioritetet që tani duhet ti implementojnë partitë politike?

Do ti kisha ndarë në dy sete. Prioriteti i parë është zbatimi i marrëveshjes së 2

qershorit dhe asaj të arritur më 15 korrik. Ka shumë çështje kritike të cilat partitë mund ti interpretojnë në mënyra të ndryshme dhe njëra nga këto çështje kritike është prokurori i veçantë, pasi që prokurori i veçantë me autonomi të plotë duket të emërohet deri më 15 shtator. Shpresoj se partitë politike do të gjejnë vetë zgjidhje por nëse ka nevojë, ne gjithsesi përsëri mund të ndihmojmë. Çështja e dytë kritike, është data 20 tetor, kur duhet të emërohen dy ministra të ri dhe pesë zëvendësi ministra. Si duket më kritike është Ministria për Punë të Brendshme.

Sa u përket reformave, Bashkimi Evropian i dha vendit dy dokumente të rëndësishëm. Dokumenti i parë përbëhet nga reforma urgjente që duhet ti realizoj vendi, ndërsa i dyti, tani më i njohur si "Raporti i Pribes", raport i cili qartë tregon çfarë duhet të bëj vendi urgjentisht, pasi që është humbur shumë kohë. Tani kemi përcaktuar grupe të punës, në të cilat katër partitë marrin pjesë, të cilat rezultuan nga takimet midis liderëve të katër partive të mëdha, ku marrin pjesë edhe BE-ja dhe SHBA-të dhe tani këto grupe të punës duhet sa më shpejtë të fillojnë me miratimin e reformave, më saktë të fillojnë menjëherë.

Z. Ambasador, a e lehtëson perspektivën evropiane kjo marrëveshje?

Paragrafi i parë marrëveshjes së 2 qershorit është më i rëndësishëm, dhe unë dëshiroj ta përsëris: "Partitë janë dakorduar që në vend të parë ti vendosin interesat e vendit dhe ta konfirmojnë angazhimin e vendit për procesin e integrimit Euro-atlantik dhe për principet demokratike". Sipas sondazheve të fundit të opinionit publik, 80% nga popullsia e vendit e mbështesin BE-në, ndërsa më shumë se 80% NATO-në. Kjo do të thotë, se kjo është dëshira e popullit, kjo do të thotë, se reformat që duhet të miratohen, duhet të zbatohen shumë shpejtë dhe në mënyrë të përsosur.

Pra kjo është një mundësi unike që Qeveria së bashku me opozitën dhe shoqërinë civile ti zbatojnë këto reforma. Nëse nuk shfrytëzohet kjo mundësi tani, ka gjasa që mos të ketë mundësi të reja. Pra, së pari marrëveshja duhet të zbatohet 100%, dhe së dyti duhet të zbatohen të gjithë reformat që i janë rekomanduar vendit.

Çfarë është agenda e BE-së për Maqedoninë, edhe pas gjashtë viteve rekomandim për hapjen e negociatave, a mund të presim që negociatat të fillojnë?

Ne, në Delegacionin e BE-së e përgatisim Raportin për progresin e vendit dhe afati i fundit për ne është 1 shtator. Ne raportojmë

për të gjitha gjërat pozitive dhe negative që i kemi parëm dhe çfarë duhet të bëhet në të ardhmen. Për fat të keq, këtë vit, deri në këtë fazë nuk ka shumë gjëra pozitive për të cilat ne mund të raportojmë por mund të raportojmë se është arritur marrëveshje politike, megjithatë është gjë normale që partitë të bisedojnë midis vete.

Pas shumë vite, kemi parë se katër liderët u ulën në tavolinë, por kjo ndodhi vetëm me ndërmjetësimin e BE-së dhe NATO-së. Mbetet vetëm edhe një muaj e disa ditë që të përgatiten dhe zbatohen reformat. Ne e dërguam listën me rekomandime dhe unë shpresoj se muaji gusht do të shfrytëzohet në mënyrë efektive. Rekomandimi për hapjen e negociatave nënkupton se vendi i plotëson Kriteret e Kopenhagës, ndërsa këto kritere nënkuptojnë se vendi i plotëson të gjitha principet demokratike.

Për demokracinë flasim të gjithë, por njerëzit e kuptojnë në mënyra të ndryshme. Demokracia do të thotë nëse unë shkoj të votoj në zgjedhje unë di se as kush nuk do të dijë për cilin kam votuar, do të thotë se nuk do të ketë presion ndaj meje dhe familjes sime për cilin të votojmë. Demokracia do të thotë që unë të shprehem lirshëm. Demokracia do të thotë nëse më shkelen të drejtat njerëzore unë mund të shkoj në gjyq dhe të jem i sigurt se gjyqi është i pavarur dhe se nuk ka presion politik.

Të gjithë këto reforma janë të domosdoshme dhe të shkruara në dokumentet, para se të gjithash në Raportin e Pribes, se çfarë duhet të ndërmerret. Tani, Qeveria, opozita dhe shoqëria civile kanë mundësi që të tregojnë se kjo ka rëndësi për ata.

E përmendët edhe Raportin e Progresit që BE-ja do ta publikoj në vjeshtë. Kriza politike do të ketë pjesërisht ndikim, megjithatë vlerësimin përfundimtar do ta dëgjojmë në tetor. Gjyqësia dhe mediat, janë sferat për të cilat nevojiten më së shumti reforma, çfarë ndryshime konkrete mund të presim në këto dikastere deri më 24 prill?

Mediat dhe gjyqësia morën shumë vërejtje kritike, në raportin tonë të vitit të kaluar. Por është interesant që shumica e mediave të vendit nuk donin të raportonin për këto kritika të publikuara në Raportin e Progresit. Në këtë vend, rregullat janë të mira, ligjet janë të përsosur, problem është zbatimi. Në këtë rast, Qeveria mund



të tregoj se kujdeset për vlerat e Bashkimit Evropian. Ne e dhamë listën tonë të prioritetëve dhe ata duhet të zbatohen. Por para se të gjithash, lira e mediave fillon nga gazetarët, redaktorët.

Nëse ekziston vetë-censura, si mund të ekzistoj gazetari profesionale? Nëse gazetarët dhe redaktorët frikohen nga diçka, si mund ata të raportojnë në mënyrë të pavarur, gjë që pritet nga televizioni shtetëror publik? TVM-ja është çështja kryesore, pasi që ju jeni të financuar nga taksapaguesit, ndërsa ata presin raportim të pavarur dhe profesional.

Edhe në kohëra të krizës politike dhe tensioneve, ekonomia e Maqedonisë qëndron mirë. Sipas të dhënave statistikore ka rritje. Numrat tregojnë se vinë investime të reja të huaja, niveli i borxhi është në mesin e borxheve më të ulëta në Evropë. Si e shihni gjendjen ekonomike të vendit?

Gjithçka ka lidhje të ndërsjellët. Kriza ekonomike me shumë mundësi ka ndikim edhe mbi zhvillimin ekonomik të vendit. Kjo është përsëri në duart e Qeverisë, në duart e opozitës dhe në duart të partive tjera. Nëse marrëveshja e 2 qershorit zbatohet në tërësi, nëse fillohet me reformat menjëherë, unë jam i bindur se këto tendenca pozitive do të vazhdojnë. Nëse nuk zbatohet marrëveshja, nëse nuk ka reforma, unë atëherë nuk jam i bindur se këto tendenca pozitive do të vazhdojnë.

Një varg projekte të BE-së zbatohen në Maqedoni. Në dispozicion janë edhe paratë e IPARD fondeve. A mund të më tregoni çfarë është interesi për paratë evropiane në vendin tonë?

Mendoj se interesi është mbresëlënës. Në BE, Politika e Përbashkët Bujqësore është një nga politikat kryesore dhe më e shtrenjtë. Ne u ndajmë shumë para shteteve anëtare të BE-së, por e bëjmë të njëjtën edhe për shtetet kandidatë. Interesi është i jashtëzakonshëm, në fakte njerëzit nuk besojnë se mund të marrin para nga BE-ja.

I shfrytëzuam manifestimet me rastin e Ditës së Evropës, 9 maj që të udhëtojmë në mbarë vendin dhe ti informojmë qytetarët se kanë mundësi të aplikojnë për fondet e IPARD dhe si të përmirësohet gjendja në sferën e bujqësisë. Ne vazhdojmë të bëjmë këtë, ka disa projekte të BE-së të fokusuar drejtë implementimit sa më të kësaj politike, dhe nënkuptohet se ne shpresojmë se kjo do të përmirësojë gjendjen e bujqësisë së vendit.

Në Maqedoni nuk ka rritje të euro skepticizmit për dallim nga disa vende tjera, që tregojnë se qytetarët llogarisin në Bashkimin Evropian, a llogarit edhe Evropa në Maqedoninë?

Sigurisht. Nëse ne nuk kujdesem, atëherë nuk do ti kishim organizuar negociatat para dy javëve. Ne kujdesemi shumë. Dëshirojmë që vendi i juaj të anëtarësohet sa më shpejtë në Bashkimin Evropian. Kujdesemi dhe shpresojmë shumë që nga ju të marrim përgjigje pozitive.

Z. Ambasador, ju falënderohem që dhatë intervistë për televizionin shtetëror.

